



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 166/3 Prot.

Patos, më 26/02 2024

PROCESVERBALI I TAKIMIT 26 SHKURT 2024

Vendi: "Salla e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak"

Ora e fillimit : 14 :00

Ora e mbarimit : 15:30

Tema e Konsultimit: "Plani Lokal i Rinisë 2024-2026"

Baza Ligjore: Në zbatim të ligjit me nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 18; Ligjit nr. 146/2012 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3 4 neni 52, ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" si dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak "Për konsultimin publik" ligji nr. 75/2019 "Për rininë" si dhe Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029.

Pjesëmarrës: Zv.Kryetare e Këshillit të Bashkisë znj. Albiona Lamaj, anëtarë të Këshillit të Bashkisë Patos, mësues, përfaqësues të QKF-së Patos dhe Rreth 45 pjesëmarës të rinj nga shkolla të ndryshme të qytetit.

Takimin hapet nga Zv. Kryetare e Këshillit të Bashkisë:

Zv. Kryetare e Këshillit të Bashkisë znj. Albiona Lamaj- Në zbatim të ligjit me nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 18; Ligjit nr. 146/2012 "Për njoftimin dhe konsultimin

publik” pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1.2.3 4 neni 52, *ligji nr. 119/2014* “Për të drejtën e informimit” si dhe Rregullores së Këshilli Bashkiak “Për konsultimin publik” ligji nr. 75/2019 “Për rininë” si dhe Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029 jemi mbledhur këtu në këtë dëgjese publike me temë **“Plani Lokal i Rinisë 2024-2026”**. Në cilësinë e zëvendës Kryetares së Këshillit Bashkiak Patos më vjen mirë dhe është kënaqësi për mua kur e shoh këtë sallë të mbushur me të rinj ku një pjesë janë edhe të gjimnazit Zhani Ciko i cili ka nxjerrë breza e breza përfshirë edhe ne që jemi sot përballë jush ku padyshim që nesër do të jeni ju që do të merrni në dorë fatet e qytetit. Unë dua t’ia kaloj fjalën drejtoreshës së arsimit në bashki znj. Elda Goxhaj e cila do të na prezantoj se çfarë është ky plan dhe përse do të na shërbej ai. Elda fjala për ju.



**Zv. Kryetare e Këshillit të
Bashkisë znj. Albiona Lamaj**

Degjese Publike me temë :
“Plani Lokal i Rinisë 2024-2026”

Shkurt 2024

Drejtores e Arsim kulturës znj. Elda Goxhaj – Faleminderit, në fakt hartimi i një dokumenti sic është Plani i Veprimit për Rininë për bashkinë Patos ku mund të them se jemi ndër bashkitë e para në vend që prezantohemi me hartimin e një dokumenti të cilin nuk e kemi parë si një detyrim ligjor, por si një qasje të bashkisë Patos për të patur një dokument të strukturuar ku ne të përcaktojmë ato detyra, angazhime dhe struktura të dedikuara që do të merren me disa objektiva



**Drejtores e Arsim kulturës
Znj. Elda Goxhaj**

Degjese Publike me temë :
“Plani Lokal i Rinisë 2024-2026”

Shkurt 2024

të cilat do të jenë në funksion të të rinjve.

Drejtoresha e Arsimit kulturës znj Elda Goxhaj – prezanton informacionin mbi planin lokal të rinisë duke përcaktuar objektivat e planit : 1. Angazhimi qytetar dhe lidhshipi 2. Punësimi dhe Sipërmarrja e të Rinjve.3. Edukimi dhe zhvillimi i aftësive. 4. Shëndeti dhe mirëqenia. 5. Sport, art dhe kulturë. 6. Siguria dhe mbrojtja

Zv. Kryetare e Këshillit të Bashkisë znj. Albiona Lamaj- faleminderit. Kush ka pyetje sygjerime apo komente?

Nxënësi i shkollës “Petro Sota” Dionis Banaj - ne kërkojmë që për të rinjtë të shtohen më shumë aktivitete sportive për të rinjtë. Gjithashtu kërkoj të kthehet formati i Miss dhe Mister Patosi.



**Nxënësi i shkollës “Petro Sota”
Dionis Banaj**

Degjese Publike me temë :
“Plani Lokal i Rinisë 2024-2026”

Shkurt 2024

Nxënësi i shkollës “Zhani Ciko” Sokol Baxhia - unë dua të ngre një shqetësim lidhur mbi qendrën pasi nuk është e mobiluar dhe kërkoj që ajo të jetë e hapur për të rinjtë cdo ditë me qëllim kryerjen e aktiviteteve të ndryshme dhe jo të jetë e hapur në ditë të caktuara dhe me orare



**Nxënësi i shkollës “Zhani Ciko”
Sokol Baxhia**

Degjese Publike me temë :
“Plani Lokal i Rinisë 2024-2026”

Shkurt 2024

të përcaktuara. Gjithashtu kërkoj të ngrihet një qendër dedikuar vetëm të rinjve.

Drejtores e Arsim kulturës znj. Elda Goxhaj : - Prjekti formati i Mis dhe mister Patosi është shumë i kushtueshëm dhe nuk mund të mbulohet me buxhetin e bashkisë

Nxënës i shkollës “Sotir Capo” Revi Mamo – të kalçetoja mungon rrjeta dhe nuk është funksionale për kryerjen e aktiviteteve sportive dhe aneksi sportiv nuk ka kushte



**Nxënës i shkollës “Sotir Capo”
Revi Mamo**

Degjesë Publike me temë :
“Plani Lokal i Rinisë 2024-2026”

Shkurt 2024

Nxënëse e shkollës “Mustafa Matohiti” Sonila Çakaj – unë mendoj se për kryerjen e aktiviteteve ne penalizohemi vetëm për faktin se nuk kemi transport ndaj kërkoj të na sigurohet transporti



**Nxënëse e shkollës “Mustafa Matohiti”
Sonila Çakaj**

Degjesë Publike me temë :
“Plani Lokal i Rinisë 2024-2026”

Shkurt 2024

Anëtar i Këshillit Bashkiak z. Eduart Faslliaj- e dëgjova me vëmendje prezantimin e planit nga ana e ekzekutivit gjithashtu edhe kërkesat tuaja deri tani. Ajo që do të doja të dija është se sa nga shkollat kanë laboratore?

Nxënës i shkollës “Zhani Ciko” Sokol Baxhia - në shkollën Zhani Ciko ka, por ne nuk mund të shfrytëzojmë labororet pasi nuk na lejojnë kryerjen e eksperimenteve laboratorike pasi ka substanca të dëmshme. Gjithashtu ka laborator informatike, por nuk e përdorim pasi nuk kemi internet në shkollë



**Nxënës i shkollës “Zhani Ciko”
Sokol Baxhia**

Degjesë Publike me temë :
“Plani Lokal i Rinisë 2024-2026”

Shkurt 2024

Anëtar i Këshillit Bashkiak z. Eduart Faslliaj- pyetja ime tani shkon për ekzekutivin kush duhet ti plotësojë labororet me bazë materiale dhe përse atje ku ka nuk shfrytëzohen nga të rinjtë dhe pyetja tjetër që doja të dija prej jush ka internet në shkollë?



**Anëtar i Këshillit Bashkiak
z. Eduart Faslliaj**

Degjesë Publike me temë :
“Plani Lokal i Rinisë 2024-2026”

Shkurt 2024

Drejtoresha e Arsimit kulturës znj Elda Goxhaj : - pajisja me bazë materiale nuk është detyrë funksionale e bashkisë ndërsa lidhur me internetin ju informoj se shkollat kanë internet dhe ne u ofrojmë asistencën tonë me IT

Anëtar i Këshillit Bashkiak z. Eduart Faslliaj: -në kuadër të programit në shkollat komunitare a keni të organizuara aktivitete sportive me qëllim që ato që nuk janë të përfshihen në grupe?

Drejtores e Arsim kulturës znj. Elda Goxhaj : - shkollat komunitare marrin fonde nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve dhe në dijeninë time në Patos shkollë komunitare është shkolla “Hekuran Maneku” e cila është funksionale në shërbim të projektit “Shkollat Komunitare” me zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme përgjatë gjithë vitit. Përsa i përket planit lokal të rinisë, ky plan i ka të përcaktuar objektivat e tij që kanë të bëjnë me: Angazhimin qytetar dhe lidhshimin; Punësimin dhe Sipërmarrjen e të Rinjve; Edukimin dhe zhvillimin e aftësive; Shëndetin dhe mirëqenien; Sportin, artin dhe kulturën dhe objektiva e fundit është Siguria dhe mbrojtja. Pra që të jemi brenda kornizave të objektivave të këtij draft plani mund të jepni sygjerimet tuaja për objektivat ose nëse keni propozime për objektiva të tjera apo zëvendësimin e një objektivave me




**Drejtores e Arsim kulturës
Znj. Elda Goxhaj**

Degjese Publike me teme :
“Plani Lokal i Rinisë 2024-2026”

Shkurt 2024

një tjetër.

Nxënëse e shkollës “Zhani Ciko” Pamela Kocaqi : - Duhet të ketë një investim për teknologjinë. Laboratorët janë të ngritur, por nuk janë funksional. Lidhur mbi objektivin kërkoj që në këtë plan të parashikohen kurse profesionale dhe marketingu.



**Nxënësi i shkollës “Zhani Ciko”
Sokol Baxhia**

Degjese Publike me teme :
“Plani Lokal i Rinisë 2024-2026”

Shkurt 2024

Zv. Kryetare e Këshillit të Bashkisë znj. Albiona Lamaj:-patjetër që çdo koment apo i juaji është mbajtur shënim ku në mënyrë të padiskutuar cdo sygjerim do të reflektohet në planin përfundimtar. Ndonjë pyetje tjetër lidhur, **“Plani Lokal i Rinisë 2024-2026”**. Mqse jo atëherë e konsideroj këtë takim të mbyllur

Konceptoi:

Koordinator i Konsultimit Publik

Suzana Hysenaj



Pranoi:

Sekretar i Këshillit

Refaela Xeba



Foto të dëgjesës publike me temë: “Plani Lokal i Rinisë 2024-2026”



